



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2020:177412

Datë: 23.04.2021

Numri i dokumentit: 01724708

P.nr.269/2020

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, gjyqtari Sadri Krasniqi, me sekretaren juridike Tevide Thaqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit R.A. nga”, për shkak të veprës penale: Vjedhje nga neni 313, parag.1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani PP.II.nr.2056/2020, të dt. 10.12.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më 08.04.2021, në prani të Prokurorës së Shtetit Huma Jetishi dhe të akuzuarit R.A., shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datën 23.04.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i :

R.A., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati R., e ëma, A., e lindur B., i lindur më në, ku edhe jeton,nr. personal, i nacionalitetit Rom, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë ka qenë i dënuar edhe më parë për vepër penale.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse,

Më datë 14.08.2020, në kohë të pacaktuar gjatë mesnatës, në Kamenicë, i pandehuri R.A., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete ose tjetrin, e ka vjedhur biçikletën e të dëmtuarit N.C. nga, në atë mënyrë që i pandehuri gjatë natës shkon te objekti banesor ku banon i dëmtuari dhe në korridorin e katit të parë ku ishte e parkuar biçikleta, të njëjtën e merrë dhe e fsheh në shtëpinë e vet, ndërsa pas bastisjes, në mesin e

shumë biçikletave të vjedhura, gjendet e demoluar edhe biçikleta e të dëmtuarit, e njëjta konfiskohet, më pastaj i kthehet të dëmtuarit, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta të dëmtuarit të sipërshtënuar i ka shkaktuar dëm material në vlerë të pa caktuar.

- me ç'rast ka kryer veprën penale: Vjedhje nga neni 313, parag.1, të KPRK-së .

Gjykata në bazë të nenit të lartë cekur dhe neneve 4, 38, 39, 42 43, 44, 69 dhe 70 të KPRK-së, lidhur me nenin 248, 365 dhe 451 të KPPRK-së, të akuzuarin R.A. e,

G J Y K O N

Me dënim kumulativ.

- me dënim me **gjobë** (të holla) në shumë prej nga **200 € (dyqind euro)**, të cilën shumë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 € do t'i llogaritet nga një ditë burgu dhe

- me dënim burgu efektiv në kohëzgjatje prej **30 ditëve**, i cili dënim në bazë të nenit 44, parag.1, dhe 2, të KPRK-së, dhe me pëlqimin e të akuzuarit do t'i zëvendësohet në dënim me gjobë, në shumën prej **300 €**, të cilin dënim me gjobë, i pandehuri ka për ta paguar në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në tri këste mujore, në të kundërtën, dënimin me gjobë, të njëjtit do ti zëvendësohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 €, do ti llogaritet nga një ditë burg.

I dëmtuari N.C. nga Kamenica, nuk i bashkangjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike

Detyrohet i akuzuari R.A., që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.2056/2020, të dt. 10.12.2020, ka kërkuar që ndaj të akuzuarit: R.A. nga të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: Vjedhje nga neni 313, parag.1, të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të akuzuarit për dat.08.04.2021, në të cilën seancë gjyqësore pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i akuzuari R.A. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, njëherit thekson se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari R.A. me dashje ka kryer veprën penale: Vjedhje nga neni 313, parag.1, të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për të cilën vepër penale, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarit për veprën penale të kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 70 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritore të dënimit ligjor. Në veçanti për këtë rast si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata pati parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari, është penduar thellë për veprën penale të kryer, të dëmtuarit i kërkon falje, gjendjen e tij të vështirë ekonomike në të cilën jeton, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepër tjetër penale. Njëherit duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën e veprës penale të kryer dhe mënyrën e kryerjes së sajë, i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimet si në dispozitiv të aktgjykimit ndaj të akuzuarit R.A., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të akuzuarit.

Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata, bazuar në nenin 451 paragrafi 1 i KPPRK-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (Njëzetë euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË KAMENICË,

P.nr. 269/2020 më datë. 23.04.2021

Gj y q t a r i,

Sadri Krasniqi d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.